



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-5296/25
Kaçanik, 05.03.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I (parë) Solemne e Kuvendit të Komunës për vitin 2026, mbajtur me 05 Mars 2026. Mbledhja u mbajt në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë, në ditën e shtunë, me fillim pune në ora 10:00.

Pjesëmarrës të kësaj mbledhje nga KK ishin 17 anëtarë, në ndërkohë erdhi anëtarë Betim Shala, kështu që pjesëmarrja ishte 18 anëtarë. Në këtë mbledhje munguan: Blerim Koxha, Shqipe Murseli, Hafize Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës ishin: Kryetari i Komunës Sabedin Vishi, Nënkryetari i Komunës, Xhelal Dema: drejtorët e drejtorive: Suhad Dullovi, Valdrin Dogani, Korab Krasniqi, Lumniqe Demnika - Selmani, Urata Sopa, Gazmend Bunjaku, Arlinda Rakoci Raka, Lulzim Krasniqi, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishte, Fatlume Guri- Zyra e Informimit, Bejtulla Dalloshi- Zyra e IT, Zyrtarja e Kuvendit-Makfiro Malsiu, Asistentja e Kryesuesit-Arianita Bajrami.

Në këtë mbledhje morën pjesë edhe:

Tahir Çaka- Ish Kryetari i Komunës së Kaçanikut,

Sali Runjeva-Përfaqësues i OVI. e UÇK-së

Hajrush Kurtaj-Zv. Komandant i brigadës 162

Jashar Selimi- Kryetar i invalidëve të luftës

Rexhep Luma -Veteran i UÇK

Hasip Salihu- Administratori i f. Bajnicë.

Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë

Mbledhjen e Kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës: Makfiro Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, Selajdin Troni, i cili theksoj se sot po mbajmë mbledhje solemne për nder të "Epopesë së UÇK-së" të vitit 1998. Kjo mbledhje solemne mbahet për nder të datave të shënuara 5, 6 dhe 7 Mars "Epopeja e UÇK", në përkujtim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharit dhe rënies heroike të Familjes Jashari. Në kujtim dhe nderim të sakrificës sublime të familjes Jashari dhe Komandantit Legjendar, Adem Jashari, iu ftoj të mbajmë një minutë heshtje.
Vazhdojmë me mbledhjen sipas kësaj.

Agjende

1. Fjala e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Selajdin Troni;
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës, Sabedin Vishi;
3. Fjalimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës; dhe
4. Fjalimi i përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së.

Në vazhdim në përkujtim të ngjarjeve të shënuara, fjalën e morën sipas Agjendës:

1.Fjala e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Selajdin Troni;

Të nderuar anëtar të kuvendit,
I nderuar kryetar, Sabedin Vishi,
I nderuar ish kryetar i komunës, Tahir Çaka,
I nderuar përfaqësues i OVL. Sali Runjeva,
I nderuar ish Komandant i Brigadës 162, Hajrush Kurtaj,
I nderuar nënkryetar, Xhelal Dema,
Të nderuara Familje të dëshmorëve, veteranëve, invalidë të luftës së UÇK,
Sot po mbajmë mbledhjen solemne të Epopesë së UÇK-së të vitit 1998,
Sot jemi mbledhur për të përkujtuar me nderim dhe krenari Epopenë e UÇK-së, një nga ngjarjet me të mëdha dhe me të lavdishme të historisë tonë me të re kombëtare.
Kjo Epope është themel i lirisë tonë, është fryma e sakrificës që ndërtoj shtetin tonë.
Në Prekaz familja heroike e Adem Jasharit dëshmuar se dashuria për atdheun, është me e fortë se 'çdo armë. Ata u bënë simbol i qëndresës e i unitetit dhe vendosmërisë për liri.
Epopeja e Prekazit ishte alarm gjithë popullor i mijëra djem dhe vajza që iu bashkuan luftës për liri, po ashtu edhe zëri i lirisë bashkoj edhe shumë bura e gra. djem e vajza të Kaçanikut, ku betejave të përgjakshme iu prinë heroi i kombit, Komandant Agim Bajrami dhe heroi i kombit Komandant Qamil Ilazi.
Si Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, ndjej përgjegjësi të veçantë që në emër të qytetarëve tanë, të shprehë mirënjohjen me të thellë për të gjithë dëshmorët dhe luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e në veçanti për gratë dhe vajzat e Kaçanikut. Heroinat tona, Mukadeze Lika Muhaxheri, Emsale Frangu, Lumrije Raka dhe Jehona Raka, që treguan se Kaçaniku ka enë pjesë e pandalshme e historisë dhe qëndresës, ku qytetarët tanë me krenari kanë kontribuar në rrugën e lirisë.
Epopeja e UÇK-së na mëson se liria fitohet me sakrificë, ruhet me përgjegjësi dhe forcohet me punë të nderhme.
Sot detyra jonë është, të ndërtojmë Kosovën për të cilët ranë dëshmorët. Lë të jetë kjo ditë zotim i përbashkët se do të punojmë me përkushtim për zhvillimin e shtetit tonë, për forcimin e institucioneve dhe ruajtjen e vlerave të luftës tonë Çlirimtare.
Lavdi e Përhjetshme Dëshmorëve të Kombit, Mirënjohje të gjithë atyre që kontribuar për liri!

Kryesuesi i Kuvendit: Vazhdojmë me Fjalimin e Kryetarit të Komunës, Sabedin Vishi.

2.Fjalimi i Kryetarit të Komunës, Sabedin Vishi

Faleminderit Kryesues,
Të nderuara familje të dëshmorëve, veteranë e invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
I nderuari ish Kryetar i Komunës, Tahir Çaka,
I nderuar Zëvendës komandant, Hajrush Kurtaj,
I nderuari, Sali Runjeva, përfaqësues i OVL
I nderuari Kryetar i Shoqatës së Invalidëve të luftës, Jashar Selimi,
Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës,
Shumë të respektuar qytetarë të komunës së Kaçanikut
Muaji mars na kujton sakrificën, dhe qëndresën e popullit tonë. Ndërsa ditët 5,6 dhe 7 Marsi, janë ditët e krenarisë sonë mbarë kombëtare dhe përkujtimit të luftës së shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të prirë nga Komandant Adem Jashari. Po sot kujtojmë

heroizmin e pa shoq të familjes Jashari e cila u bë akt themeltar për lirinë e atdheut, duke u bërë një rast i veçantë kudo nëpër botë, një familje e bashkuar stoike, e për tu bërë me vonë monument përjetësie në historinë tonë.

Për tri ditë radhazi, në Kullat e Jasharajve, në këto kulla të qëndresës, kjo familje u bëri ballë sulmeve të fuqishme, ku burra, gra e fëmijë, luftuan deri në frymën e fundit, me një qëllim e ideal të përbashkët.

Kjo sakrificë sublimë nuk ishte vetëm një akt trimërie, por edhe themeli mbi të cilin u ndërtua qëndresa e armatosur e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku u ndez drita e shpresës dhe u vulos vendosmëria e një populli për të mos u nënshtuar kurrë.

Epopeja e UÇK-së është një dëshmi e gjallë se liria nuk është dhuratë, por fryt i sakrificës dhe i gjakut të derdhur nga bijtë dhe bijat me të mira të këtij vendi.

Sot përkulemi me respekt të thellë para familjeve të dëshmorëve, duke shprehur mirënjohjen tonë të përhershme për sakrificën e tyre. Liria që gëzojmë sot është përgjegjësi e madhe dhe amanet që duhet ruajtur me atdhedashuri, unitet dhe përkushtim. Të nderuar të pranishëm

Si institucione, gjithmonë do të kemi përgjegjësi të veçantë që vlerat e luftës çlirimtare t'i ruajmë, t'i kultivojmë dhe historinë tonë çdo herë ta trasojmë tek brezat e rinj, tek brezat e lirisë.

Në këtë ditë të shënuar e të rëndësishme për secilin nga ne, kujtojmë sakrificën sublimë të dëshmorëve, martirëve, ushtarëve e eprorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kujtojmë sot sakrificën edhe për qindra e mijëra djem dhe vasha të anës së Kaçanikut që tashmë ishin rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nën udhëheqjen madhështore të dy komandantëve Agim Bajrami e Qamil Ilazi.

Janë bërë mbi dy dekada që nga ajo ngjarje, por sado që koha kalon, Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të jetë monumenti me i mirë i përjetësisë dhe kauza e vet popullit tonë, me vite e shekuj për liri e pavarësi të vendit.

Lë të jetë Epopeja e UÇK-së frymëzim për unitetin tonë kombëtar dhe udhërrëfyes për ndërtimin e një Kosove të drejtë, të fortë dhe demokratike, të denjë për gjakun e derdhur për liri.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit!

Nderim i përhershëm luftëtarëve të lirisë!

Lavdi për Epopenë e UÇK-së!

Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit: Ju falënderoj kryetar për fjalën. kalojmë të

3.Fjalimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës;

Fjalën e ka një përfaqësues nga subjekti politik nga Partia Demokratike e Kosovës

3.1 Nga Subjekti Politik, Partia Demokratike e Kosovës, fjalë rasti mbajti shefi grupit, Bashkim Krasniqi

z. Bashkim Krasniqi: I nderuari Kryetar, Kryesues, Familje të dëshmorëve, Përfaqësues të Organizatave të dala nga lufta e UÇK, të nderuar të pranishëm,

Sot jemi mbledhur këtu, për të nderuar Kapitullin me të lavdishëm të historisë sonë kombëtare, Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kur marsi vjen me erën e lirisë, zemrat tona kthehen drejt Prekazit legjendar, aty ku koha u ndal, për ti hapur rrugë lirisë. Aty ku familja Jashari në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari, nuk zgjodhi të dorëzohet apo të zmbrapset, por qëndroi deri në

frymën e fundit për idealin e lirisë. Ajo që ndodhi aty, nuk ishte fundi, por ishte fillimi, fillimi i një kushtrimi që u dëgjua anë e mbanë trojeve shqiptare. Ishte ideali që rrahu për një popull të tërë dhe nga ai ideal dolën djemtë dhe vajzat me të mira që iu bashkuan Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Sot kur ecim të lirë në këtë tokë, çdo hap është amanet. Çdo flamur që valëvitet, është dëshmi e sakrificës dhe trimërisë. Çdo frymëmarrje është borgj ndaj atyre që sakrifkuan gjithçka, sepse liria nuk është dhuratë-ajo është amanet.

Tash flasim për një të vërtetë që nuk zbehet kurrë, sepse Liria ka Emër-ka emrin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne e nderojmë lirinë, por kur shohim udhëheqësit e luftës së UÇK të cilët kanë sakrifkuar gjithçka për këtë liri, duke u përballur me një gjykim të padrejtë, mendja dhe ndërgjegjja në këto raste janë me ta.

Lë të jemi të denjë për gjakun dhe sakrificën e dëshmorëve dhe të ushtarëve çlirimtarë të Kosovës, duke mbajtur lirinë dhe drejtësinë si amanete të përhershme për këtë vend. Respektojmë dhe nderojmë dëshmorë

Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit

Nderim i përhershëm luftëtarëve të lirisë

Respekt familjeve të dëshmorëve

Lavdi Epopesë së UÇK!

Kryesuesi i Kuvendi: Faleminderit z. Bashkim, vazhdojmë me Lëvizjen Vetëvendosje. Fjalën e ka një përfaqësues nga subjekti politik nga i LVV.

3.2 Nga Subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, fjalën e mori, shefja e grupit, Kadrije Lika-Troni

znj. **Kadrije Lika Troni:** I nderuar Kryetar, Sabedin Vishi,

I nderuar Kryesues i Kuvendit, Selajdin Troni,

I nderuari ish Kryetar i Komunës, Tahir Çaka,

Të nderuar përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta,

Të nderuar familjarë të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Të nderuar Ekzekutiv i komunës, kolegë asambleistë

Të nderuar qytetarë të Kaçanikut,

Zonja dhe zotërinj

Sot jemi mbledhur në këtë seancë solemne të Kuvendit Komunal, në kuadër të shënimit të Epopesë së UÇK-së, për të nderuar një nga faqet me të rëndësishme të historisë sonë të re.

Epopeja e UÇK-së nuk është vetëm një datë, ajo është simbol i sakrificës, i qëndresës dhe i vendosmërisë për të jetuar të lirë dhe me dinjitet. Ajo na kujton vendimin e guximshëm të atyre që në rrethana të vështira zgjodhën lirinë mbi nënshtrimin.

Në këto ditë përkujtimi, përulemi me respekt të thellë para veprës dhe sakrificës së komandantit Adem Jashari, familjes Jashari, dhe të gjithë dëshmorëve të kombit, të cilët me sakrificën e tyre përcaktuan drejtimin historik të vendit tonë.

Në të njëjtën kohë, ne shprehim mirënjohjen tonë edhe për komunitetin ndërkombëtar, veçanërisht për NATO-n, ndihma e të cilëve ishte vendimtare për ti hapur rrugën paqes dhe stabilitetit që gëzojmë sot.

Gjithashtu, jemi të vetëdijshëm se krerët e UÇK-së janë duke u përballuar me procese të padrejta gjyqësore në Hagë. Shpresojmë se drejtësia do të triumfojë shumë shpejt dhe se

Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk do të njolloset nga kjo gjykatë e njëanshme dhe e padrejtë.

Por sot, këtu, kjo histori na prekë edhe me shumë, sepse edhe Kaçaniku ka dhënë bijtë dhe bijat e vet për liri. Kaçaniku ka qenë dhe mbetet vatër e atdhedashurisë dhe sakrificës. Dëshmorët dhe luftëtarët e kësaj treve, janë pjesë e pandashme e historisë së përgjithshme të rezistencës. Emrat e tyre janë të gdhendur në kujtesën tonë kolektive.

Epopeja e UÇK-së na kujton se liria kërkon unitet, angazhim dhe përgjegjësi. Mbi çdo dallim që mund të kemi, qëndron interesi i përbashkët për të forcuar shtetin tonë, për t'i shërbyer qytetarëve tanë dhe për të ndërtuar një të ardhme me të mirë.

Përgjegjësia jonë sot është që idealet për të cilat u sakrifikuan të kthehen në vepra: në sundim të ligjit, në arsim cilësor, në zhvillim ekonomik dhe në institucione të forta e transparente. Ky është nderimi me i madh që mund t'ua bëjmë brezave të sakrificës.

U përulemi me nderim të përjetshëm dëshmorëve të kombit dhe qëndrojmë pranë familjeve të tyre me respekt të thellë.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve dhe martirëve të kombit.

Kryesuesi i Kuvendi: Faleminderit znj. Kadrije, vazhdojmë me Lidhjen Demokratike të Kosovës-LDK. Fjalën e ka një përfaqësues nga subjekti politik nga i LDK.

3.3 Nga Subjekti politik, Lidhja Demokratike të Kosovës, fjalë rasti mbajti, shëfja e GP.
Ardita Rrahmani

znj. Ardita Rrahmani: I nderuar kryetar, nënkryetar, kryesues, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, familje të dëshmorëve, z. Çaka, z. Runjeva, dhe z. Kurtaj, veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e gjithë ju qytetarë të Komunës së Kaçanikut.

Kam nderin që në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës dega në Kaçanik të uroj gjithë juve e gjithë qytetarët e Kaçanikut dhe Republikës për ditët e lavdisë kombëtare, 5-6-7 Marsin e njohur si Epopeja e UÇK.

Kjo Epope përfaqëson një moment kthese në historinë e re të Republikës duke simbolizua qëndresën e një familje të tërë Jashari në Prekaz, në Marsin e gjakosur të 1998.

Epopeja e UÇK është një kujtesë e përhershme se nuk ka liri pa sakrificë.

Epopeja e UÇK flet se si pushkët e Jasharëve nuk ishin vetëm armë po ishin sa i një populli për të jetua të lirë në token e vet.

Epopeja e UÇK flet se si çdo plumb që jehonte në Prekazin e Adem Jasharit ishte britmë e një populli që kërkon dinjitet e çdo shtëpi e djegur ishte plagë në shpirtin e një kombi.

Kjo Epope është me shume se një betejë, është një betim për brezat që sakrificat e dëshmorëve të mos harrohet dhe flamuri i lirisë të valëvitet gjithmonë me nder.

Lavdi e përjetshme për dëshmorët, nderime për ta!

Kujtimi i tyre do të jetojë sa të rrahë zemra e secilit kosovar.

Nderime të përpjetme për çdo veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Kryesuesi i Kuvendi: Faleminderit znj. Ardita, vazhdojmë me Vizionin për Zhvillimin e Kaçanikut-VZHK. Fjalën e ka Hestet Malsiu. Fjala për ju komandant.

3.4 Nga Subjekti Politik, Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut, fjalë rasti mbajti shëfi i grupi, Hestet Malsiu

z. Hestet Malsiu: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm në këtë seancë solemne të Kuvendit të Komunës, përshëndetje të veçanta e të përzemërta për familjet e dëshmorëve.

invalidët dhe luftëtarët e UÇK-së, përshëndetje edhe për të gjithë ju bashkëqytetarë kudo që jeni.

Jemi mbledhur sot në përkujtim të sakrificës së pa shembullt në historinë e popullit tonë, dhe memories historike të njerëzimit. Pra sot kujtojmë rezistencën e familjes Jashari me në krye komandantin legjendarë Adem Jasharin, rezistencë e cila e bëri kthesën vendimtare në historinë e Kosovës.

Rënia heroike e komandantit ishte kushtim që frymëzoi dhe mobilizoi mijëra djem e vajza të cilët thellë në shpirt e kishin të kalitur ndjenjën e sakrificës për atdhe, ata të cilët do ta vazhdojnë luftën deri në përfundim të sajë, me çka realizuan amanetin e komandantit, mijëra dëshmorëve të UÇK-së dhe shumë brezave para tyre.

Natyrisht që lirinë e vendit nuk e kemi arrit vetëm me një betejë dhe as me vetëm një përpjekje historike, sepse gjatë një shekulli robëri, përpjekjet për çlirim kanë qenë të vazhdueshme, andaj ne sot kujtojmë Lëvizjen Kaçake, Ballin Kombëtarë, NDSH-në, kujtojmë organizatat politike ilegale, me ç 'rast kujtojmë bacë Adem Demaçi, simbolin e rezistencës, vepra e të cilit ishte motiv dhe forcë për çdo patriot që ti kundërvihet padrejtësive dhe shtypjes që bënte regjimi jugosllav mbi popullin tonë.

Kujtojmë dhe lëvizjen studentore të vitit 1981 dhe gjithë ata veprimtarë e të burgosur politik që me vizionin dhe qëndresën e tyre arritën të thyejnë dhe mposhtin propagandën antishqiptare të një sistemi të tërë shtetëror. Po ashtu kujtojmë edhe lëvizjen gjithë popullore të viteve të nëntëdhjeta në shërbim të institucionalizimit paralel, me refuzim paqësor të okupimit serb, të udhëhequr nga Dr. Ibrahim Rugova. Të gjitha këto përpjekje, secila në mënyrën e vet e kanë rolin e tyre historik për çlirim dhe pavarësi, por pa dyshim projekti më i suksesshëm politik - ushtarak i këtij shekulli ishte UÇK-së.

Falë guximit e trimërisë së luftëtarëve, dhe vizionit të qartë politik të udhëheqësve të sajë, përpjekjet tona shekullore u kurorëzuan suksesshëm, fillimisht me çlirimin e vendit, e më pas edhe me shpalljen e pavarësisë.

Por lufta dhe betejat politike dhe diplomatike në ruajtje të fryteve të luftës dhe shtetësisë së Kosovës ishin dhe vazhdojnë të jenë në kontinuitet, herë më sfiduese e të dhembshme e herë më pak. Një nga këto beteja po zgjatë qe pesë vite në një proces të pa besë politik gjyqësor, verdikti i të cilit urojmë që të bazohet në fakte, gjë që do të nënkuptonte se vendimi do të jetë shfajësues për udhëheqësit tanë të luftës e të institucioneve shtetërore.

Për kohëzgjatësi, sot kur kujtojmë sakrificën sublime të komandantit legjendar dhe familjes së gjerë Jashari, dhe nivelin e vetëdijes dhe ndjenjën e përgjegjësisë deri në flijim kolektiv për të ardhmen e popullit dhe të vendit, po sot në Kuvendin e Republikës pritet të votohet zgjedhja e presidentit të Kosovës, ku do të kemi rastin të shohim nivelin e përgjegjësisë institucionale të zgjedhurve të popullit.

Në situatën globale të sigurisë në të cilën gjendemi, në një botë të trazuar si asnjëherë më parë, është luks i tepruar shkaktimi i problemeve institucionale, edhe pse qëndron arsyeimi për cenimin e funksionimit demokratik të institucioneve shtetërore.

Uroj që deputetët e Kuvendit të Republikës duke reflektuar mbi këtë ngjarje që po e përkujtojmë sot, të jenë në nivelin e përgjegjësisë dhe të zgjedhin të keqen më të vogël për vendin.

Sakrifika e komandantit legjendarë, e familjes së tij dhe gjaku i dëshmorëve duhet të jenë gjithmonë referencë për vendimmarrje nga ata që do të kenë fatin dhe përgjegjësinë të udhëheqin me institucionet e vendit.

Lavdi dhe respekt për të rënë dhe të gjallë të familjes legjendare Jashari!

Lavdi të gjithë dëshmorëve të UÇK-së!

Respekt për plagët dhe djersën e luftëtarëve!

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit z. Heset, vazhdojmë me pikën e radhës. Fjalën e ka një përfaqësues i shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së:

4. Fjalimi i përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së;

Nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, fjalë rasti mbajti, Sali Runjeva

Para se të fillon me fjalimin z. Runjeva, anëtar i KK nga VZHK, Kjani Zeneli e vendosi para tij, Flamurin e UÇK-së.

z. Sali Runjeva: Të nderuar përfaqësues të institucioneve,
Të nderuar familjarë të dëshmorëve, veteranë e invalidë të luftës,
Të nderuar të pranishëm,
Sot jemi mbledhur për të kujtuar sakrificën sublime të familjes Jashari, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari.
Epopeja e UÇK-së kujtohet si moment me madhor i historisë sonë të re-si dëshmi e madhështisë së një familjeje që idealin për liri e vendosi mbi jetën. Një familje që pranoi të flijojë, sepse besonte që liria e një kombi ia vlen te me shumë se çdo gjë tjetër. madje edhe mbi gjakun e tyre.
Kjo sakrificë epike bëri kthesën më të madhe në historinë tonë kombëtare. Ajo mobilizoi mbarë kombin dhe e bindi bashkësinë ndërkombëtare se populli shqiptar e donte lirinë me çdo kusht- dhe se ajo nuk negociohej me asnjë çmim. Sepse, për ne, ishte më mirë të vdekur sesa në robëri.
Akti vetë flijues i familjes Jashari i dha drejtim të pakthyeshëm rrugëtimit të UÇK-së. U bë e qartë se liria do të fitohej me jetë a vdekje. Mobilizimi i radhëve të UÇK-së mori hov të jashtëzakonshëm. Ideali i lirisë u brumos në zemrat dhe shpirtin e luftëtarëve, të cilët nuk e ndalën luftën deri në ditën e çlirimit.
Liria u arrit me gjak dhe sakrificë.
Kaçaniku legjendar iu përgjigj me forcë e guxim kësaj thirrjeje. Qysh në fillim të vitit 1998, radhët e UÇK-së në komunën tonë filluan të konsolidoheshin me intensitet të madh. Forcat okupatore serbe na ndiqnin në çdo hap. Dhe me 10 gusht në fshatin Gabrricë në një betejë të pabarabartë bie heroikisht komandanti, Agim Bajrami së bashku me dy dëshmorët, Xheladin Kurtaj dhe Besnik Begunca.
Brigada 162 me krenari mori emrin "Agim Bajrami" dhe deri në çlirimin e vendit mori pjesë në shumë betejë, ku ranë shumë dëshmorë e shumë të tjerë dhanë gjymtyrët dhe sot janë invalid.
Sot kujtojmë me nderim të thellë dhe përulemi para tyre, sepse amaneti i tyre ishte liria që ne sot e gëzojmë.
Organizata e Veteranëve të Luftës, është e përkushtuar që të ruajë dhe promovoj vlerat e luftës, sakrificën e ushtarëve të UÇK-së, të nderoj dëshmorët, invalidët dhe veteranët. Sepse nderimi i luftës çlirimtare nuk është nder vetëm për ta-është nder për vet qytetarët tanë. Është kujtesë për sakrificën dhe gjakun e derdhur për lirinë që sot e kemi. Obligim i brezave të rinj është që të njohin të vërtetën e kësaj lirie-si erdhi ajo dhe sa shtrenjtë u pagua me gjakun e dëshmorëve dhe me sakrificën e invalidëve e veteranëve, me shumë civil të vrarë, fëmijë, gra e pleq.
Tani që u bënë gati 27 vite nga çlirimi i Kosovës, Serbia me rrjetin e saj me rrjetin e saj propagandues, po mundohet që luftën e UÇK-së, ta paraqes si "Organizatë e Përbashkët Kriminale", me qëllimin e vetëm që ta rishkruaj historinë dhe ta rikthejë çështjen e Kosovës në tryezën ndërkombëtare. Ne besojmë që drejtësia do të triumfojë dhe krerët e UÇK-së të kthehen shumë shpejt në Kosovë.

Të nderuar qytetarë, sot, akti patriotik është mbrojtja e asaj që u fitua me gjak, në mënyrë që amaneti i dëshmorëve të përmbushet.

Në emër të OVL-UÇK, ju falënderoj për fjalën që mu dha.

Mesazhi ynë, ashtu si në luftë, është i qartë: vetëm të bashkuar do të jemi me të qartë dhe kujtesa për rrugën sesi arritëm deri këtu, na shtron rrugën drejt një të ardhmeje me të sigurt dhe me të mirë.

Lavdi dëshmorëve të kombit!

Lavdi Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit Sali, atëherë Lavdi e përjetshme të gjithë të rënëve për liri, të gjithë dëshmorëve të kombit, respekt të veçantë të gjithë atyre që dhanë kontribut të veçantë për liri. Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje, e konstatoj përfundimin e mbledhjes në ora 10:40, për të vazhduar me agjendat tjera.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



Selajdin Troni

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 12 Tetorit 2025);

Në mbledhja e I (parë) Solemne e Kuvendit të Komunës, (Legjislatura e 8 e KK), për vitin 2026, mbajtur me 05.03.2026:

1. Selajdin Troni.....	_____
2. Blerim Koxha.....	_____
3. Xhelal Ceka	_____
4. Brahim Imishti	_____
5. Bashkim Krasniqi,.....	_____
6. Lejla Muhaxheri Çaka	_____
7. Elona Gjini.....	_____
8. Shqipe Murseli	_____
9. Enis Vishi.....	_____
10. Kadrije Lika Troni.....	_____
11. Ernesta Krasniqi	_____
12. Islam Gashi	_____
13. Buletin Guri	_____
14. Jeton Luma	_____
15. Betim Shala	_____
16. Samedin Rexha,.....	_____
17. Ardita Rrahmani	_____
18. Heset Malsiu	_____
19. Kijani Zeneli	_____
20. Lejla Luta	_____
21. Hafize Sallahi,.....	_____

prezent



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-5296/26
Kaçanik, 03.03.2026

FTESË PËR MBLEDHJE SOLEMNE

Në bazë të Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL lidhur me Organizimi i aktiviteteve në shënim të Epopesë së UÇK-së, më 5 dhe 6 Mars të datës 03.03.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik organizon Mbledhje Solemne për nder të datave të shënuara 5, 6 dhe 7 Mars “Epopeja e UÇK”, në përkujtim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharit dhe rënies heroike të Familjes Jashari.

Mbledhja do të mbahet me 05 Mars 2026, në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë, me fillim pune në ora 10:00 (Dita e Enjte).

Mbledhjen do ta hap Kryesuesi i Kuvendit, ndërkaj në përkujtim të ngjarjeve të shënuara, do të flasin sipas kësaj Agjende:

1. Fjala e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Selajdin Troni;
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës, Sabedin Vishi;
3. Fjalimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës; dhe
4. Fjalimi i përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

